

STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
VINCENTE 1 SHPK

KAPITULLI I

FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHEZGJATJA

Neni 1 - Forma

- 1.1 Shoqeria "VINCENTE 1" sh.p.k (ne vijim "Shoqeria") krijohet ne formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me ane te ketij Statuti dhe Aktit te Themelimit .
- 1.2 Shoqeria vepron sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.
- 1.3 Akti i Themelimit dhe Statuti jane ne perputhje me legjislacionin shqiptar qe ka karakter te detyrueshem , ndersa ceshtjet qe nuk jane shprehimisht te parashikuara ne to , plotesohen nga legjislacioni shqiptar.

NENI 2 - EMERTIMI

- 2.1 Emertimi i shoqerise eshte " VINCENTE 1" SH.P.K


NENI 3 - OBJEKTI I SHOQERISE

- 3.1 Shoqeria ka si objekt veprimtarie :

- **Ne fushen e marketingut shoqeria do te kryeje:**

Marrdhenie me Publikun;Shvillim Softwer;Marketing;Konsulenc Kompanish; Ndermjetsim komercial;Administrime imobilare ;Sherbime ne fushen e Media Planing;Produksioneve Televizive si dhe Produksioneve te Marketingut;Sherbime dhe krijim i websajteve(faqe interneti);Reklama online dhe Offline;Logo;Spote si dhe organizim eventesh;Sherbime printimi;Publikime;Fushata MediAtike sensibilizimi si dhe cdo veprimtari te lidhur me fushen e Mrrdhenies me Publikun dhe Marketingun;Trajnime dhe Workshop;Lidhja e Marrdhenieve me te trete;Te negocioj me te trete per marrdhenie Financiare(Huamarrje dhe Huadhenie) .

- **Ne fushën e ndërtimit shoqëria do të kryejë:** Studimin, projektimin, konsulencën, sipërmarrjen zbatuese dhe /ose investimin, sipas rastit, për realizimin me fonde publike dhe/ ose jopublike të veprave me karakter shfrytëzimi dhe/ose administrimi publik dhe/ose privat si : ndërtimin e ndërtesave publike dhe private, rrugëve, urave, tuneleve,



mbikalimeve e nënkalimeve, autostradave, traseve hekurudhore, digave dhe veprave bonifikuese e ujore, ujësjellësave, linjave mbitokësore dhe nëntokësore për energjinë dhe telekomunikacionet, ndërtimin dhe reabilitimin e veprave ujitëse, centralet, objektet turistike, objektet ushtarake, objektet e kultit, rrjetet inxhinierike, portet, aeroportet, objektet industriale, të gjitha restaurimet në përgjithësi, rikonstruksione të veprave të artit, montimet e konstruksioneve metalike.

- **Në fushën e tregtisë shoqëria do të kryejë:** Tregtimin e materialeve të ndërtimit gjithfarlojesh, si tulla, hekur, beton, materiale rifiniture dhe çdo lloj materiali dhe lende të pare që shërben në fushën e ndërtimit. Tregtimin dhe import-eksportin e mallrave si : Makineri dhe adresatura për përpunimin dhe prodhimin e produkteve të kafesë : Importimin e produkteve të kafesë të përpunuara dhe të papërpunuara etj : Prodhimin dhe përpunimin e kafesë sipas kërkesave të tregut në Shqipëri dhe në Ballkan : Tregtimin dhe import-eksportin e mallrave si : Pajisje Profesionale për Bare , Restorante , Piceri , Hoteleri etj : ushqimorë, industrialë, mjekësorë, alkoolike , jo alkoolike, dhe të gjithë metaleve me ngjyrë , të kartonave dhe plastikave , të mallrave të ndryshëm si elektrike, mekanike, elektronike, Montimi e prodhimi i elementeve të pajisjeve të ndryshme elektronike , elektroteknike, përfshirë kondicioner, elektroshtepiake, kozmetike, etj të këtij lloji. Bojrat e ndryshme me baze ujore dhe baze vajore për lyerje të fasadave të murit , të drurit të hekurit etj, stuko patinimi koll , poliretaneve dhe të veglave të punës që përdoren për lyerjen e tyre , materialeve të tjera të ndërtimit , duhan cigareve të të gjitha llojeve , të ndërtimit, të mediave , të mjeteve kryesore dhe ndihmëse të prodhimit, të makinerive, të metaleve ferrozë dhe joferrozë, të lëndës drusore, të lëndëve të para dhe të përpunuara për procesin e prodhimit, tregtimin e pasurive të luajtshme e të paluajtshme, shitblerjen e tokës, tregtimin e mallrave të gatshëm e gjysëm të gatshme etj.
- **Në fushën e transportit, shoqëria do të kryejë:** Studimin, projektimin, konsulencën, sipërmarrjen zbatuese dhe /ose investimin, sipas rastit, për realizimin me fonde publike dhe/ ose jopublike të infrastrukturës dhe /ose të pjesëve përbërëse të saj, për transportimin publik dhe /ose privat të njerëzve dhe mallrave brenda dhe jashtë territorit të vendit si dhe tranzitimin e tyre përgjatë territorit të Shqipërisë nëpërmjet transportit rrugor, hekurudhor, ajror, ujor, teleferik etj
- **Në fushën e turizmit shoqëria do të kryejë:** Studimin, projektimin, konsulencën, sipërmarrjen zbatuese dhe /ose investimin, sipas rastit, për realizimin me fonde publike dhe/ ose jopublike të infrastrukturës dhe /ose të pjesëve përbërëse të saj, për

shfrytëzimin njerëzor me karakter pushues, argëtues, edukues dhe/ose kurues, të burimeve natyrore, kulturore, mjedisore kurative, të Shqipërisë dhe më gjerë.

- **Në fushën e mjedisit shoqëria do të kryejë:** Studimin, projektimin, konsulencën, sipërmarrjen zbatuese dhe /ose investimin, sipas rastit, për realizimin me fonde publike dhe/ ose jopublike të mbrojtjes dhe ose përmirësimit si dhe rehabilitimit të kushteve të mjedisit rrethues; përpunimin e mbetjeve urbane, toksike, radioaktive, teknologjike si dhe mbetje të çdo lloji tjetër, trajtimi i ujrave industriale, projektimin, mbikqyrjen në fushën e kërkimit dhe shfrytëzimit të lëndës drusore, trajtimin dhe mbrojtjen e pyjeve, riaftësimin dhe trajtimin e tokave të kripura e kënetave si dhe çdo veprimtari që ka rëndësi për shoqërinë.

- **Në fushën e prodhimit shoqëria do të kryejë:** Studimin, projektimin, konsulencën, sipërmarrjen zbatuese dhe /ose investimin, sipas rastit, për realizimin e prodhimit me fonde publike dhe/ ose jopublike të materialeve të ndërtimit, prodhimin e inerteve, të asfalto-betonit, betonit, prodhimin e vajrave të ndryshme ushqimore dhe jo ushqimore, prodhimin e sapunëve, prodhimet e konstruksioneve metalike, beton armeje, plastike, të drurit dhe kombinime të ndryshme të tyre, prodhimin e bojrave dhe llaqeve të ndryshëm, të ambalazheve, çdo operacion industrial prodhues; prodhimin e motorrave dhe transformatorëve elektrikë, transformatorët e tensionit të lartë, furrave elektrike, reaktorëve të çdo tipi dhe të gjitha paisjeve elektrike, studime dhe projekte për paisje dhe makineri elektrike.

- **Në fushën e shërbimeve shoqëria do të kryejë:**

Dhënie me qera të aseteve të shoqërisë (të godinave dhe të Trullit) shoqërive vendase dhe të huaja ; Prodhim dhe tregëtim mobilje , dyer,produkte dhe aksesori alumini , dritare druri,tregëti bojra të ndryshme ,vegla pune ,aksesori dhe paisje hidraulike,paisje elektroshtepiake , paisje elektrike , materiale ndërtimi etj, parket druri dhe laminat ,prodhim dhe montim fasada xhami , bar kafe etj .Konsulencë teknike në fusha të ndryshme, supervizion, menaxhimet dhe studimet e të gjitha llojeve, realizimi i kontratave, marrëveshjeve, ortakërive, shoqërive të përbashkëta apo forma të tjera, veprimtari komisionere, servis për tipet e ndryshme të automjeteve, përfaqësim, si dhe veprime të tjera të porositura nga të tretët të lejuara nga legjislacioni shqiptar; riparimin dhe remontet e mesme dhe kapitale të makinave elektrike rrotulluese të çdo tipi fuqie e tensioni, të motorrave dhe transformatorëve elektrikë, transformatorëve të tensionit të lartë, furrave elektrike, reaktorëve të çdo tipi si dhe të gjitha paisjeve elektrike; konsulencë, revizion, ekspertizë, vlerësime të kapitaleve dhe gjendjes, planbizneseve,

projekte zhvillimi dhe studime të efektiviteteve ekonomike, përcaktimi i prioriteteve në fusha të ndryshme të ekonomisë etj. Administrim fondesh dhe/ose investimesh.

- **Në fushën e botimeve shoqëria do të kryejë:** Studimin, projektimin, konsulencën, sipërmarrjen zbatuese dhe /ose investimin, sipas rastit, për botimin e gazetave, revistave, posterave, reklamave dhe botimeve të tjera
 - **Në fushën e Telekomunikacionit shoqëria do të kryejë:** Studimin, projektimin, konsulencën, sipërmarrjen zbatuese dhe /ose investimin, sipas rastit, për realizimin e impianteve të telekomunikacionit dhe shërbimet e ndërlidhjes në internet, administrimi, vendosja dhe përdorimi i impianteve fikse dhe të lëvizshme për transmetime radiotelevizive. Kryerja e çdo operacioni ekonomik e juridik, prodhues dhe tregtar e financiar, që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë së shoqërisë, për të cilin, në bazë të legjislacionit shqiptar, kërkohet leje e posaçme nga organet kompetente të administratës publike, do të realizohet vetëm pasi të jetë siguruar leja përkatëse.
- 3.2 Gjithashtu shoqëria mund të kryejë kërkime të tregut, të zhvillojë marka dhe patenta, organizojë rrjete tregtare, të nënshkruajë kontrata agjencie, projekte impiante dhe ofroje, edhe indirekt asistencë teknike në lidhje me aktivitetet e mesipërme.
- 3.3 Nëse fundi, shoqëria mund të kryejë çdo operacion tregtar, operacione që lidhen me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si edhe të blejë dhe të shesë ose marrë me qira ndermarrje, dege ndermarrjesh, si dhe të ketë interesa ose pjesëmarrje në shoqëri, ente, konsorciume, të themeluara apo në themelimin e sipër, që kanë objekt të njëjtit ose të ngjashëm me të veten apo gjithësesi funksional për arritjen e qëllimeve të shoqërisë, si dhe të japë garanci, të marrë hua dhe të ofrojë garanci pasurore apo personale, në favor të tjerëve. Nëse në përgjithësi, shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë përfshirë edhe aktivitetin e importit dhe eksportit të produkteve.

NENI 4 - SELIA

- 4.1 Selia e shoqërisë është në: Rruga, "Andon Zako Cajupi", Pallati 22/2, Hyrja 14, Tiranë.
- 4.2 Transferimi i selisë së shoqërisë në një vend tjetër bëhet me Vendimin e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë ose të Asamblesë së Ortakëve.
- 4.3 Asambleja e Ortakëve mund të vendosë hapjen e filialeve, degeve dhe perfaqësive të shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë si dhe jashtë saj.

NENI 5 - Kohezigjatja e veprimtarisë

- 5.1 Kohezigjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë pa afat.

5.2 Shoqeria mund te priset perpara ketij afati ose mund te zgjase kohezgjatjen e saj me vendim te Ortakut te Vetem.

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR , KONTRIBUTET , NDARJA E PJESEVE TE KAPITALIT

NENI 6 - Kapitali themeltar

6.1 Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100 Lek ,dhe ndahet ne 1 pjese me 100% ose 100-Lek per 1-pjese.Ai mund te rritet me vendim te asamblese se ortakeve sipas normave te fushes ne fuqi.

Kapitali ndahet në 1 (nje) pjese me vlerë nominale 100-Lek për pjese, të numëruara nga 1 (një) deri në 1 (nje) përfshi dhe numrin e fundit të shlyera në masën 100% nga , Ortaket themelues ne raporte me zoterimin e kapitalit themeltar .

NENI 7 - Kontributet

7.1 Kontributet ne kapitalin e Shoqerise eshte ofruar si me poshte

-Zt.Andrea VIRAGH shtetas italian , lindur ne Rome me 12.09.1960 dhe banues ne Durres ne Adresen :Lagja nr.1, Rruga " Taulantia " , Durres , i cili kontribuon dhe zotëron 1 (nje) pjese me vlerë 100-Lek (Njeqint) Lek per pjese e barabarte 100 % te kapitalit themeltare te shoqerise prej 100(Njeqind) Lek;

Ky kapital është i vlefshëm për regjistrimin e shoqërisë sipas nenit 43 te ligjit nr.9723 , date 03.05.2007 " Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit " .

NENI 8 - Rritja e kapitalit themeltar

8.1 Kapitali themeltar mund te rritet pa kufi ne cdo moment, nje ose disa here, me vendim te Ortakut te Vetem ose Asamblese se Ortakeve qe perfaqesojne te pakten $\frac{3}{4}$ (tre te katertat) e kapitalit themeltar.

8.2 Ne rast rritjeje te kapitalit, te gjithë ortaket kane te drejten te nenshkruajne rritjen ne raport me pjeset e kapitalit te zoteruara. Ne rast se disa nga ortaket nuk e ushtrojne kete te drejte, pjeset e tyre mund te nenshkruhen nga ortaket e tjere proporcionalisht me pjesemarrjen respektive.

Neni 9 – Zvogelimi i kapitali themeltar

9.1 Shoqeria mund te zvogeloje kapitalin themeltar me vendimin e Ortakut te Vetem ose te Asamblese se Ortakeve, me voten pro te ortakeve qe zoterojne te pakten $\frac{3}{4}$ (tre te katertat) e kapitalit themeltar. Ne cdo rast kapitali themeltar nuk mund te zvogelohet nen kufijte e parashikuar nga ligji.

- 9.2 Zvogelimi i kapitalit perballohet nga secili prej ortakeve ne te njejten mase me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre.

Neni 10 – Transferimi i pjeseve te kapitalit dhe e drejta e parablerjes

- 10.1 Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve.
- 10.2 Ne rast transferimi te pjeseve te kapitalit ne cdo lloj formr ne favor te personave te tjere nga ata te parashikuar me siper, si me shperblim ashtu edhe pashperblim, me cdo kusht, duke perfshire edhe dhurimin, oratket e tjere gezojne te drejten e parablerjes mbi keto pjese kapitali.
- 10.3 Ne rast te tille ortaku qe do te transferoje pjeset e tij te kapitalit duhet t'i njoftoje ortaket e tjere, me leter rekomande, mbi synimin per shitjen, cmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blesesit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes i referohet te gjitha pjeseve te kapitalit ofruar per shitje.
- 10.4 Ortaket do te kene ne dispozicion 15 (pesembedhjete) dite nga marrja e letres rekomande, per t'i komunikuar ortakut qe transferon pjeset e kapitalit, synimin e tyre per te ushtruar apo jo te drejten e parablerjes. Ne rast se ata nuk pergjigjen ne afatin e caktuar, prezumohet se kane hequr dore nga e drejta e tyre e parablerjes.
- 10.5 Ne rast se oferta pranohet nga disa ortake, pjeset e kapitalit te ofruara nga ortaku qe transferon pjeset e kapitalit, do te ndahen nga ortaket pranues, ne te njejten mase me pjeset qe ata zoterojne, pervec rastit kur ka nje marreveshje te kundert. Ne asnje rast, pranuesi i ofertes nuk mund te ushtroje pjeserisht te drejten e parablerjes.
- 10.6 Ne rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, pjeset e kapitalit mund t'i transferohen te treteve plotesisht apo pjeserisht, me vendimin e Asamblese.
- 10.7 Pjeset e kapitalit te Shoqerise jane lirisht te transferueshme per shkak trashegimie *mortis causa*. Ne rast te vazhdimet te Shoqerise me disa trashegimtare te oratkut te vdekur, trashegimtarete duhet te emerojne nje perfaqesues te perbashket.

KAPITULLI III

ASAMBLEJA, ADMINISTRATORET DHE EKSPERTI KONTABEL

Neni 11 – Asambleja e ortakeve dhe kompetencat e saj

- 11.1 Organi vendim-marres i Shoqerise eshte Ortaku i Vetem ose Asambleja e Ortakeve.
- 11.2 Ortaku i vetem ose Asambleja e Pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per ceshtjet vijuese: ndryshimet e statutit, emerimin dhe/ose shkarkimin e administratoreve, eksperteve kontabel e likuidatoreve, zmadhimin dhe/ose zvogelimin e kapitalit, transferimin e

kuotave, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise, miratimin dhe per cdo ceshtje tjeter parashikuar nga ky Statut apo nga legjislacioni ne fuqi.

Neni 12 – E drejta e pjesemarrjes dhe e votes

- 12.1 Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne Asamble, te paraqese mendimin e tij dhe te jape aq vota sa eshte numri i pjeseve te kapitalit qe ai zoteron.
- 12.2 Cdo ortak ka te drejte te perfaqesohet nga nje qqeson tjeter jo-ortak, i pajisur me prokure me shkrim, me anen e se ciles mund te jape voten e tij.
- 12.3 Ortaku nuk mund te leshoje prokure per votim per nje pjese te kapitalit qe zoteron, ne qofte se voton personalisht per pjesen e mbetur.

Neni 13 – Thirrja e Asamblese se Ortakeve

- 13.1 Asambleja e Ortakeve thirret te pakten nje here ne vit, brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit financiar per miratimin e bilancit, te raportit te Administratorit, ekspertit kontabel si dhe inventarit.
- 13.2 Asambleja mund te thirret ne cdo moment nga nje prej Administratoreve ose nga likuidatori/likuidatoret si dhe prej nje ose disa ortakëve te minorances sipas parashikimeve te ligjit ne fuqi.
- 13.3 Asambleja duhet te thirret nepermjet njoftimit me leter rekomande qe duhet t'u dergohet ortakëve – ne adresen qe rezulton ne Librin e Ortakeve – dhe ekspertit kontabel (nese eshte emeruar), te pakten 15 (pesembedhete) dite perpara mbledhjes se Asamblese. Thirrja duhet te permbaje informacion mbi llojin e Asamblese, mbi ceshtjet qe do te trajtohen dhe per te cilat do te merret vendim, mbi vendin, oren dhe daten e thirrjes se pare dhe te dyte.
- 13.4 Asambleja mund te thirret edhe jashte selise se Shoqerise, ne Itali ose ne Shqiperi.
- 13.5 Mbledhjet e Asamblese mund te mbahen edhe nepermjet telekonferences dhe videokonferences, me kusht qe te gjithe pjesemarrsit te mund te identifikohen dhe t'i lejojeh atyre te ndjekin diskutimin dhe te nderhyjne ne momentin e trajtimit te argumenteve; pasi te jene verifikuar keto kerkesa qe duhet te rezultojne ne procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur ne vendin ku ndodhet Kryetari ne te cilin duhet te ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.
- 13.6 Asambleja do te thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve te njoftimit, ne rast se jane te pranishem oratket qe perfaqesojne te tere kapitalin themeltar.
- 13.7 Vendimet e Asamblese se Pergjithshme, per te cilat eshte e nevojshme nje shumice e zakonshme, jane te vlefshme nese jane te pranishem oratket me te drejte vote qe zoterojne me shume se 30% (tridhete perqind) te kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblese se Pergjithshme,

per te cilat eshte e nevojshme nje shumice e cilesuar, jane te vlefshme nese jane te pranishem oratket me te drejte vote qe zoterojne te pakten 75% (shtatedhjet e pese perqind) te kapitalit themeltar.

- 13.8 Asambleja e Pergjithshme vendos per ndryshimet e statutit, zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit te regjistruar, transferimin e kuatave, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise me voten pro te te $\frac{3}{4}$ (tre te katertat) te oratkeve pjesemarrjes te cilet perfaqesojne te pakten 75% (shtatedhjet e pese perqind) te kapitalit themeltar te shoqerise. Ne te gjitha rastet e tjera, Asambleja e Pergjithshme merr vendimet ne mbledhje te zakonshme me voten pro te shumices se oratkeve te pranishem qe perfaqesojne mbi 30% (tridhjetete perqind) te kapitalit themeltar.
- 13.9 Cdo Asamble drejtohet nga nje ortak ose nje person tjetër i caktuar nga e njejta Asamble. Per pasqyrimin e vendimit Asambleja emeron nje Sekretar, qe mund te jete edhe jo-ortak.
- 13.10 Vendimet e Asamblese duhet te nenshkruhen nga Kryetari i Asamblese dhe nga Sekretari.

Neni 14 – Administrimi

- 14.1 Shoqeria administrohet nga 1 (nje) Administrator i cili qendron ne detyre per nje periudhe 5 (pese) vjecare deri ne revokimin apo doreheqjen e tij , me te drejte ripertesitje .
- 14.2 Administratori ka te gjitha kopetencat e administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshem te Shoqerise ne kufijte e objektit te Shoqerise me perjashtim te atyre kompetencave qe sipas ligjit apo Statutit i perkasin Asamblese se Ortakeve.
- 14.3 Perfaqesimi ligjor i Shoqerise i besohet Administratorit.
- 14.4 Administratori mund te emeruje perfaqesues te posacem per veprime apo kategori te caktuara veprimesh.
- 14.5 Administratorit mund t'i jepet nje shperblim vjetor, edhe si pjesemarrje ne fitime, ecila duhet te percaktohet me vendim te Asamblese se Ortakeve. Gjithashtu, ne aktin e emerimit mund te percaktohet edhe nje kompesim per administratorin ne rast te perfundimit te mandatit.
- 14.6 Per ato te drejta dhe detyra qe nuk jane percaktuar ne kete statut , Administratori ose Administratorete i nenshtrohen detyrimeve ligjore nga neni 95 deri te neni 98 te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 “ Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare “ .
- 14.7 Administrator i pare i Shoqerise emerohet - Zt. Klaus SULAJ per nje periudhe 5-vjecare , nga viti 2019 deri ne vitin 2024.

Neni 15 – Eksperti kontabel i autorizuar

- 15.1 Ne rast se kerkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakeve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabel te Shoqerise mund t'i besohet nje Auditoruesit Ligjor, emeruar per 5 (pese) vite.
- 15.2 Audituesi Ligjor mund te shkarkohet sipas menyres se parashikuar nga legjislacioni ne fuqi.

KAPITULLI IV

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPERNDARJA E FITIMEVE

Neni 16 – Viti financiar dhe bilanci vjetor

- 16.1 Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te secilit vit.
- 16.2 Viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te Shoqerise ne Qendren e Regjistrimit Kombetar dhe perfundon me 31 dhjetor te te njejtit vit.
- 16.3 Bilancet vjetore, raportet e Administratorit dhe ekspertet kontabel te autorizuar (nese eshte emeruar) miratohet nga Asambleja me shumicen e oratkeve qe perfaqesojne me teper se 75% (shtatedhjete e pese perqind) te kapitalit themeltar.
- 16.4 Miratimi i dokumentave qe lidhen me vitin financiar duhet te behet brenda 6 (gjashte) muajve qe nga viti i vitit financiar.

Neni 17 – Fitimet

- 17.1 Fitimet qe rezultojne nga bilanci vjetor, duhet zbritur 5% (pese perqind) qe caktohen per rezerven ligjore deri ne 10% (dhjete per qind) e kapitalit themeltar, dhe duke zbritur gjithashtu te gjitha shumatat qe Asambleja vendos t'i vere menjane, u shperndahen oratkeve ne proporcion me pjeset e kapitalit themeltar te zoteruara.
- 17.2 Asambleja mund te vendose edhe zbritje te vecanta ne favor te rezervave te jashtezakonshme ose per qellime te tjera apo edhe shtyrjen shperndarjes se fitimeve, plotesisht ose pjeserisht, per vitet financiare te ardhshme.

KAPITULLI V

SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Neni 18 – Prishja

- 18.1 Shoqeria priset me perfundimin e afatit te parashikuar nga Statuti, ose perpara perfundimit ne rastet e parashikuara nga ligji, ose me ane te nje vendimi te asamblese se Ortakeve, me shumicen e kerkuar per ndryshimet ne statut.
- 18.2 Shoqeria nuk priset ne rast te humbjes se zotesise per te vepruar, pazotesise juridike, vdekjes, ose falimentimeve te ortakeve.

Neni 19 – Likuidimi

- 19.1 Ne rast prishje, Shoqeria duhet te likuidohet.
- 19.2 Per te administruar kete procedure, Asambleja emerone nje ose me shume likuidatore, te cilet paraqesin raportet perfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetin te Shoqerise, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohen e nevojshme per te perfunduar likuidimin.
- 19.3 Me perfundimin e procedures se likuidimit, Asambleja do te vendose mbi bilancin financiar perfundimtar, mbi punen e krye nga likuiduesi dhe mbi perfundimin e procesit te likuidimit.
- 19.4 Pas pagimit te kreditorëve dhe mbledhjes se kredive, likuidatori do t'i shperndaje te ardhurat perfundimtare te likuidimit ortakeve, ne proporcion me pjeset e kapitalit te zoteruar prej tyre ne kapitalin themeltar.

Neni 20 – Zgjidhja e mosmarreshjeve

- 20.1 Te gjitha mosmarreshjet qe mund te lindin ne lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e ketij statuti dhe aktit te themelimit, si edhe ato qe mund te lindin ne pergjithesi midis oratkeve (pervec atyre personale apo jashte Shoqerise) ose midis nje apo me shume oratkeve dhe Shoqerise, do te zgjidhen ne menyre miqesore dhe do te diskutohen ne menyre te drejteperdrejte ndermjet paleve te interesuara.
- 20.2 Ne rast se nuk arrihet ne nje zgjidhje miqesore te mosmarreshjes, ato do t'i besohen Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 21 – Gjuha

- 21.1 Ky statut eshte hartuar ne 4 (kater) kopje ne gjuhen shqipe
- 21.2 Per te gjitha mosmarreshjet qe mund te lindin ne lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e ketij Statuti, versioni ne shqip do te jete i vetmi dhe do te jete ligjerisht detyrues.
- 21.3 Autorizohet Administratori i shoqerise zt.Klaus SULAJ, te bej depozitim te akteve te themelimit ne Q.K.B.

Tirane , me 20 Korrik 2019

ORTAKE I VETEM I SHOQERISE

Andrea VIRAGH

